



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr. 505 Prot

Elbasan më 22 .11 .2021

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarivë te ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”.

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Bletërritës- 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën

- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Te kete diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem,ne profesionin e kursit te formimit profesional per te cilin po aplikon;
- b) Te kete te pakten 3 (tre) vjet pervojë pune ne fushen ,ne te cilen eshte kualifikuar;
- c) Te njohë dhe te perdore teknologjine e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit të vendit të lire , duhet të përfshijë.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Te gjithë dokumentat duhet të jene origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jene të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin të ofrimit publik të AFP-së brenda datës.....03.12.2021

